



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 16302 prot.

Vlorë, më 28.12 2023

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, Datë, \_\_\_\_\_ 2023

**“Për dhënie Titulli “Nderi i Qytetit” për Ekipin e Futbollit “Flamurtari” te vitit 1980-1990**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, pika 2, neni 9/1, pika 1/b dhe 7/a; neni 54, pika m, ne Ligjin nr. 112/2013, datë 04.04.2013 “ Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë “ neni 14, neni 15, pika 1/a dhe 2/b neni 16, në relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë Vlorë si dhe me propozim të Prefektit të Qarkut Vlorë

**VENDOSI:**

1. T’i japë titullin “Nderi i Qytetit ” për ekipin e Futbollit “Flamurtari” te viteve 1980-1990 ,me këtë motivacion:

**“Per rezultate të shkëlqyera në arenën kombetare dhe ndërkombëtare si dhe kontributin dhe përfaqësimin me dinjitet të futbollit vlonjat dhe shqiptar”.**

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë dhe Kryetari i Bashkisë Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “ neni 55, pika 6.

Konceptoi: S.Kalemi  
Miratoi: D.Demiri



**KRYETARI**

**Ermal DREDHA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË  
DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. 16302 prot.

Vlorë, më 28.12 2023

**RELACION MBI PROJEKT VENDIMIN**

**PËR DHENIE TITULLI “NDERI I QYTETIT” PËR EKIPIN E FUTBOLLIT  
“FLAMURTARI” TE VITIT 1980-1990**

**PARA KËSHILLIT BASHKIAK**

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt-Vendimi **“Për dhënie Titulli “Nderi i Qytetit” për Ekipin e Futbollit “Flamurtari” te vitit 1980-1990**, që ju paraqesim për miratim bazohet në propozimin e Prefektit të Vlorës.

Prefekti i Qarkut pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga Kryetari i Shoqatës z.Vasil Ruci për propozimin dhënien e titullit *“Nderi i qytetit”* Ekipit të Futbollit Flamurtari të viteve 1980-1990 vendosi ta paraqesë në Bashki kete kerkesë për të iniciuar procedurën e nderimit dhe vlerësimit të këtyre figurave të sportit.

Ekipi i Futbollit Flamurtari që krijoi emrin e këtij klubi të madh , janë përfaqësues të një gjenerate të artë, që është skalitur në kujtesën e sportdashësve jo vetëm për futbollin e Vlorës, por edhe për atë kombëtar. Kjo gjeneratë u kthye në krenarinë e qytetit duke promovuar vlerat më të mira të qytetit të Vlorës me arritje të shkëlqyera sportive në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare në futbollin ballkanik dhe atë evropian.

Këta futbollistë kanë shkruar historinë e futbollit vlonjat dhe shqiptar konkretisht:

Ndër arritjet më të spikatura përmenden :

- Fitues i Kupës së Republikës dy herë ( 1985,1988)
- Kampion Kombëtar i Kampionatit të 52-të të Futbolli ( 1990-1991)
- Fitues i Superkupës së Shqipërisë.( 1990,1991)
- Renditja në vendin e 16 më të mirët e Europës në kompeticioni UEFA CUP (1987-1988).

- 4 Ndeshje për kupën ballkanike me bilancin 2 fitore
- Ndeshjet historike Flamurtari-Barcelona, dhe Flamurtari-Partizani i Beogradit

Referuar sa parashtruam më lartë vlerësojmë se është në nderin e Këshillit të Bashkisë Vlorë të miratojë këtë Projekt- Vendim për të nderuar dhe vlerësuar keto figura të sportit

**KRYETARI**

**Ermal DREDHA**

